



Shtyrja e afatit të pagesës së kësteve të tatimit mbi fitimin dhe dorëzimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave

Në vijim të masave të marra nga qeveria e Republikës së Shqipërisë për lehtësimin dhe përballimin e pasojave të rezultuara nga pandemia Covid-19, në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 24.04.2020 janë publikuar Aktet Normative nr.18, datë 23.04.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe nr. 19, datë 23.04.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar sipas të cilëve parashikohen afate të reja për parapagimin e kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin e thjeshtuar sipas kategorive të caktuara të tatimpaguesve, shtyrjen e afatit të dorëzimit të deklaratës individuale të të ardhurave, si dhe përjashtime të reja nga taksat e ndikimi në infrastrukturë.

● Afate të reja dhe përjashtime të parapagimeve të kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin e thjeshtuar

Më poshtë paraqiten në mënyrë skematike, afatet e reja të parapagimit të kësteve të tatimit mbi fitimin, si dhe kategoritë e tatimpaguesve të cilëve iu zbatohen:

Detyrimi ligjor	Kategoria e tatimpaguesve	Afati ligjor përjashtimor sipas Paketës Financiare nr. 1	Afati ligjor përjashtimor sipas Paketës Financiare nr. 2
Prepayment of corporate income tax installments for year 2020	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor > 14 milionë Lekë, përvec veprimtarive të mëposhtme: - bankë; - telekomunikacion; - tregtimi i produkteve farmaceutike; - tregtimi i produkteve ushqimore dhe fruta – perimeve	30 mars, 30 qershor, 30 shtator, 30 dhjetor 2020 (nuk kishte shtyrje të afateve)	Këstet e 30 qershorit dhe të 30 shtatorit të vitit 2020 do të shtyhen për periudhën prill - shtator 2021. Nuk ka shtyrje për këstin e 30 dhjetorit.
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor < 14 milionë Lekë	Kurdo brenda 31 dhjetorit 2020	Nuk do të paguhet
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin e thjeshtuar me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë Lekë	20 prill, 20 korrik, 20 tetor, 20 dhjetor (nuk kishte shtyrje të afateve)	Nuk do të paguhet
	Tatimpaguesit në fushën e turizmit dhe të përpunimit aktiv me material porositësi, si dhe call center	Në varësi të përgjegjësisë tatimore dhe qarkullimit	Këstet e tatimit mbi fitimin për periudhën prill-dhjetor 2020 do të shtyhen për periudhën prill - dhjetor 2021.



Ndër të tjera, sipas akteve normative të mësipërme parashikohen gjithashtu:

- **Shtyrja e afatit të dorëzimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave dhe pagesës së detyrimit (nëse rezulton me detyrim) më 31 korrik 2020 (afati ligjor i zakonshëm ishte 30 prill 2020);**
- **Përfshihen nga pagesa e taksës mbi ndikimin në infrastrukturë investimet në kuadër të programeve të rindërtimit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.**

Parashikimet e mësipërme ligjore hyjnë në fuqi menjëherë duke filluar nga 25.04.2020.



Extension of the deadline for payment of corporate income tax installments and submission of Annual Personal Income Tax Declaration

Following the measures taken by the Government of the Republic of Albania to facilitate and cope with the consequences of the Covid-19 pandemic, in the Official Gazette no.73, dated 24.04.2020 are published the Normative Acts no.18, dated 23.04.2020, "On some amendments and additions in the Law no. 8438, dated 28.12.1998, "On Income Tax", as amended" and no. 19, dated 23.04.2020 "On some amendments and additions in the Law no. 9632, dated 30.10.2006, "On local taxes system", as amended" according to which new legal deadlines are provided for prepayment of corporate income tax and simplified corporate income tax installments, extension of the deadline for submission of Annual Personal Income Tax Declaration, as well as new exemptions from tax of impact on infrastructure.

● New deadlines and exemptions on prepayment of corporate income tax and simplified corporate income tax installments

Below are schematically presented the new deadlines for prepayment of corporate income tax installments, as well as categories of taxpayers to whom they apply:

Legal obligation	Taxpayers' category	Exceptional legal deadline according to Financial Package no. 1	Exceptional legal deadline according to Financial Package no. 2
Prepayment of corporate income tax installments for year 2020	Taxpayers subject to corporate income tax with annual turnover > ALL 14 million, except the activities listed as below: - Bank; - Telecommunication; - Trade of pharmaceutical products; - Trade of food products	30 th of March, 30 th of June, 30 th of September, 30 th of December, 2020 (there was no extension of deadlines)	Installments of 30 th of June and 30 th of September, 2020 will be postponed to April - September 2021. There is no deadline extension for the installment of 30 th of December.
	Taxpayers subject to corporate income tax with annual turnover < ALL 14 million	Anytime within 31 st of December, 2020	Will not be paid
	Taxpayers subject to simplified corporate income tax with annual turnover from ALL 5 to ALL 8 million	20 th of April, 20 th of July, 20 th of October, 20 th of December (there was no extension of deadlines)	Will not be paid
	Taxpayers operating in tourism and active processing with ordering material, as well as call center	Depending on tax liability and turnover	Installments of corporate income tax for the period April - December 2020 will be postponed to April - December 2021



Amongst others, according to the above Normative Acts, the following are also foreseen:

- **Extension of the deadline for submission of Annual Personal Income Tax Declaration and payment of liability (if results in a liability position) on 31st of July, 2020 (the regular deadline was 30th of April, 2020);**
- **Investments under the reconstruction programs to cope with the consequences of the natural disaster are excluded from the payment of the tax of impact on infrastructure.**

The above legal provisions enter into force immediately starting from 25.04.2020.